

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi - U ekstradua nga Italia, Gjykata e Posaçme lë në burg Hasan Ndërkakun
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/919076/u-ekstradua-nga-italia-gjykata-e-posacme-le-ne-burg-hasan-nderjakun/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 09:32:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 09:04:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	89b21478b3a2fbf92bc55643aa070ed73e7f264faded69ccaf4b8523b566ea19
TEKSTI	45b426c0dd458ae8a8bfd5c7249be9bb1f972f5fd2caf0ad148d3a2122f77be7
PAMJA	73ce74acb69d0cfc2f8767fd53dcdc533093d0afbbaacd01f4e8623b41936b6d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	99dfef99fb79d27963a342a2fdd13fb77e8c62815ceb23fa410de4399c200ac1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5232afb02d0ef3cfba4c89fffc05e27ccc8e2122c3335e6361f8bbb2dc579865
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/99dfef99fb79d27963a342a2fdd13fb77e8c62815ceb23fa410de4399c200ac1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtareve

**ENVER BYTYQI**

Vendimi i Hagës dhe raportit ynë me të vërtetën!

**më të lexuarat**

FOTO/ Shqiptarët arratisen me një BMW X6 të vjedhur, aksidentojnë tre makina dhe plagosin një polic

Zjarret/ Në qarkun Lezhë u dogjën 2500 hektarë pyje dhe 12 banesa

Zjarri në Gjirin e Lalzit vijoi gjatë natës, u evakuuan turistë e banorë

Tentuan të transportonin 6 emigrantë drejt Greqisë, arrestohen dy persona në Sarandë

EMRAT/ Plagosën të riun pas sherrit për riparimin e makinës, shpallen në kërkim babë e bir

Vrasja në Tiranë/ Zbardhet dëshmia e autorit: U zëmë me fjalë, e godita disa herë me thikë në bark



U ekstradua nga Italia, Gjykata e Posaçme lë në burg Hasan Ndërbakun

11:04, 25/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur të lërë në burg Hasan Ndërbakun, i cili u ekstradua nga Italia vetëm dy ditë më parë në Shqipëri.

Ndërbaku ishte shpallur në kërkim nga autoritetet shqiptare dhe ndaj tij ishte caktuar në mungesë masa e sigurisë "arrest në burg", nën dyshimet për përfshirje në grup të strukturuar kriminal.

Pas arrestimit në Itali, Hasan Ndërbaku kishte qëndruar në masën e "arrestit në shtëpi", deri në përfundimin e procedurave të ekstradimit drejt Shqipërisë.

Gjatë seancës së zhvilluar këtë të premte në GJKKO, mbrojtja kërkoi që në dosjen gjyqësore të administrohej edhe vendimi i Gjykatës italiane, i cili përcakton kushtet dhe kufijtë mbi të cilët ishte lejuar ekstradimi i Ndërbakut.

Avokati i tij, Rigert Koni, deklaroi se vendimi i gjykatës italiane nuk ishte administruar as nga Prokuroria dhe as nga Gjykata, pavarësisht se klienti i tij ishte ekstraduar në Shqipëri vetëm pak ditë më parë.

Mbrojtja kërkoi që vendimi italian të merrej në konsideratë, veçanërisht për pjesën që lidhet me akuzën e "grupit të strukturuar kriminal".

Sipas avokatit Koni, autoritetet italiane nuk kanë pranuar ekstradimin e Ndërbakut për këtë vepër penale, duke e lejuar ekstradimin vetëm në lidhje me akuzën për shitje të lëndëve narkotike.

Megjithatë, pavarësisht kërkesës së mbrojtjes, Gjykata e Posaçme vendosi vijimin e masës së sigurimit "arrest në burg" për Hasan Ndërbakun.

Ndërbaku ishte shpallur në kërkim në kuadër të operacionit të koduar "Ura", një hetim i autoriteteve shqiptare ndaj një grupi të dyshuar për veprimtari kriminale të lidhur me narkotikët.

Tashmë, pas ekstradimit të tij në Shqipëri dhe vendimit të GJKKO-së, Hasan Ndërbaku do të qëndrojë në burg, ndërsa çështja ndaj tij do të vijojë të shqyrtohet nga drejtësia shqiptare.

Lexo edhe:



Përvetësimi i 700 milionë lekëve nga Posta Shqiptare/ Ish-drejtoresha del nga burgu



Dy shtetas kosovarë, janë arrestuar në Itali - U kapën duke transportuar 7.5 kilogramë kokainë



Rodos/ Shqiptari i merr 15 mijë euro polakes dhe e kërcënon me fotot nudo

Rodos/ Shqiptari i merr 15 mijë euro polakes dhe e kërcënon me fotot nudo

Detaje tronditëse/ Ergys Agasi mori të dhënat e telefonave të 'zbërthyer' nga policia

Arrestohen në flagrancë 2 persona, policia u gjen në banesa armë dhe municion luftarak

TË NGJASHME



'Porositësit e ushqimit'/ Lushnje, arrestohen shitësit e kokainës, e shpërndanin me motora



Zjarret/ Në qarkun Lezhë u dogjën 2500 hektarë pyje dhe 12 banesa



FOTO/ Shqiptarët arratisen me një BMW X6 të vjedhur, aksidentojnë tre makina dhe plagosin një polic



Kishin ngritur një 'mega-fabrikë' droge në qytet, shkatërrohet rrjeti shqiptar në Spanjë



Agasi strehohej te vilat e klanit 'Troplini'/ BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të tij



Shqiptari pranon fajësinë në SHBA për krime kibernetike, drejtoi platformën Rydox



EMRI/ Shqiptari vdes pasi ra në gropën e ashensorit në Itali, trupi u gjet falë ziles së celularit

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.